

Nexhmi BUSHATI

NDIHMESA TË DIJETARËVE SHKODRANË NË FUSHËN E ORIENTALISTIKËS

Është fare e shpjgueshme të pranosh se dijetarët që merren me orientalistikë, fushë studimesh për njohjen e vendeve të Lindjes, detyrimisht emërtohen orientalistë, mirëpo orientologjia bart dy ngarkesa kuptimore të ndryshme, të varura nga qëllime të ndryshme, i pari, politik, i dyti, shkencor.¹ Disa dijetarë perëndimorë iu kushtuan orientalistikës, jo për qëllime thjesht shkencore, por me pikësynime politike në mënyrë që njohja dhe studimi i vendeve të Lindjes t'u paraprinte planeve hegjemoniste e kolonializuese të shteteve të veta. Përballë këtij qëndrimi radhiten orientalistët e mirëfilltë, që, me përkushtim, përvetësuan gjuhët orientale (turqisht, arabisht, persisht) për t'u njohur me historinë, jetën e zakonet, fenë e kulturën e atyre vendeve, të udhëhequr nga qëllimi fisnik e human.

Do të përpiqem të jap një panoramë përgjithësuese të atyre arritjeve, që dijetarët shkodranë realizuan në fushën e mësipërme. Analiza do të shtrihet në kohë, nga shek. XVIII deri në ditët tona, ndonëse është e vështirë të vendosësh kufij të qartë. Mendoj se mund të dallohen këto etapa:

- Gjuhët dhe kultura e Lindjes në mjedisin shkodran, kontaktet, ndikimet e zhvillimet e dukshme të arsimit e të kulturës. Periudha e përkthimeve dhe botimi i fjalorëve 2-3 gjuhësh,
- Arritje të mirëfillta shkencore të dijetarëve të shquar të së kaluarës së afërt,
- Punonjës shkencorë të ditëve tona në fushën e Orientalistikës.

Duke i vendosur në kohë, na rezulton kjo ndarje:

- Gjysma e shek. XVIII deri në vitet '70 të shek. XIX.
- Fundi i shek. XIX deri në vitet '50 të shek. XX.
- Vitet '50 deri në vitet '90 të shek. XX.
- Vitet '90 e këtej.

Shkodra, me zhvillimin e saj ekonomik e shoqëror, në gjysmën e 2-të të shek. XVIII² e më tej, njohu dhe një zhvillim të dukshëm të arsimit dhe të kulturës.³ Hapja e institucioneve, të tilla si: medrese, teqe, biblioteka etj. krijoi mundësi të veçanta për njohjen, mësimin dhe përvetësimin e gjuhëve të lindjes e, për rrjedhojë, njohjen e kulturës së atyre popujve, një dukuri e dobishme me shumë interes për zhvillime të mëvonshme e të mëtejshme në dinamikën e jetës shpirtërore e shoqërore.

Nisma e Mehmed Pashë plakut për hapjen e Medresesë së Qafës, ndjekur më vonë nga Kara Mahmud Pasha,⁴ me Medresenë e Pazarit dhe bibliotekën përkatëse, të cilat më vonë Mustafa Pasha i shndërroi në një ansambël kulturor-arsimor,⁵ ku ishin të pranishme dhe predispozitat për informim e studim jashtë sferës fetare, krijoi traditën e shëndoshë të krijimit dhe të bibliotekave familjare, me inventarë librash fetarë dhe jofetarë, në gjuhët e Lindjes, e, pse jo, dhe në shqip, me alfabetin turko-arab. Mjafton të kujtojmë ato të familjeve Tabaku, Myftia⁶ që kanë gëzuar dhe vlerësime optimale nga studiues vendas e të huaj. Sundimtarët Bushatllinj dhanë shembullin personal si dashamirës të kulturës, jo vetëm se morën arsimin bashkëkohor për rangun e tyre, brenda ose jashtë vendit, jo vetëm se përkrahën nismat e dobishme, por se ata mbetën bibliofilë “të thekur”, që bibliotekat e veta, krahas librave fetarë, i pasuruan me ata të gjuhësisë, të historisë, të drejtësisë, të kozmografisë, të logjikës, të retorikës apo të letërsisë e të poezisë. Krahas argumenteve të njohura të studiuesve H. Bushati,⁷ Sh. Osmani,⁸ G. Shpuza,⁹ N. Krasniqi, vitet e fundit u njohëm dhe me të dhënat e autorit A. Emiriu,¹⁰ sipas të cilit: “... me që Ibrahim Pasha (Bushatlliu) ishte një poet i zoti, iu dha titulli “Halili” (i sinqertë, mik)”. Duke iu referuar veprës “Poetët e Shkodrës”,¹¹ të autorit Emiriu, arrihet

në përfundimin se Shkodra, me rrethinat, ishte një “rezervuar” talentesh të spikatura, që krijonin sipas modeleve të poezisë orientale, duke u bërë “autorë gazelesh, kasidesh dhe divanesh në gjuhë turqisht, arabisht e sidomos persisht”.¹² Duke qenë se Shkodra nuk ishte vetëm një qendër studimi e përvetësimi të kulturës së Lindjes, por edhe qendër lëvrimit e saj, në veçanti e poezisë persiane, bijtë e saj nuk mbetën vetëm “konsumatorë” pasivë, por dëshmuuan duke dhënë ndihmesën e tyre në mbajtjen gjallë të lidhjeve kulturore e shpirtërore përmes krijimtarisë dinjitoze. Kjo traditë lehtësoi kalimin e natyrshëm nga një etapë në tjetrën, duke ruajtur vazhdimësinë, ndonëse “koha e artë”, ajo e sundimtarëve Bushatllinj apo “vakti i vezirëve”, sipas Ippen-it, kishte marrë fund. Ish nxënësit e tyre, pasi kishin kryer studimet e larta në Stamboll, Kajro etj., ishin kthyer në qytetin e tyre dhe po jepnin mësim duke zëvendësuar myderrizët e huaj, sjellë prej Bushtallinjve nga Krimeja, nga Egjypti, nga Bullgaria, Konja, Edirneja.¹³ U krijua kështu një elitë e re, që mbante në gjirin e saj personalitete të shquara si Jusuf ef Tabaku, Sali Myfti Plaku, Sheh Shamia, Daut Boriçi, H. Halit Bushati etj., që, me përkushtimin e tyre në mësimin e gjuhëve dhe të përhapjes së kulturës orientale, krijuan atë shtrat të nevojshëm për veprimtari intelektuale, duke filluar nga përkthimet, për të vazhduar me hartime fjalorësh dygjuhësh, me letërsi shqipe me alfabet turko-arab, por me fillimet e alhamiadës shqiptare.¹⁴

Është etapa e dytë (çereku i fundit i shek. XIX), kur dukuri të tilla do të jenë të pranishme qoftë me veprimtarinë e Daut Boriçit, qoftë në atë të H. Ali Ulqinakut: I pari,¹⁵ me një fjalor të paplotësuar turqisht-shqip. I dyti,¹⁶ me tre fjalorët e tij dygjuhësh, krahas përkthimit të mevludit nga osmanishtja dhe krahas abetares shqip me alfabetin arab. Krahas punës së frytshme të dy autorëve të lartpërmendur, duhet vlerësuar edhe shkalla e lartë e zotërimit të gjuhëve orientale nga ana e disa dijetarëve shkodranë, të cilët arritën nivele të tilla sa u thirrën të jepnin jo vetëm leksione fetare, por dhe gjuhësie, në institucione të njohura arsimore të Turqisë, Egjiptit, Sirisë, Libanit etj. Të tillë lektorë qenë edhe H. Ibrahim Kraja, H. Ibrahim Kaduku, H. Ymer Bakalli, Sheh Ahmet Shkodra dhe, në ditët tona, Imam Vehbi Ismaili dhe Haxhi Vehbi Gavoci.¹⁷

Përkthimeve në shqip nga letërsia orientale, fetare apo laike, ashtu si veprave origjinale në fushën e islamologjisë, në veçanti të orientalistikës, në përgjithësi iu përkushtuan autorët e mëposhtëm: Sheh Ahmet Shkodra (“Mevludi” ‘Ilahitë’), H. Abaz Golemi (“Poezi të Saadiut”), H. Esat Myftia (2 fjalorë doracakë dygjuhësh, 1 manual tregjuhësh, Hadithe dhe proverba arabe). Është pohuar se H. Ibrahim Kaduku ka lënë në dorëshkrim një punim në arabisht të titulluar “Masa e gjurmëve të mira dhe ndryshimet¹⁸”.

Në krye të këtij përkushtimi qëndrojnë dy personalite të larta të islamizmit shqiptar e më tej: I pari, H. Vehbi Gavoci,¹⁹ me 20 vepra origjinale fetare në shqip, po kaq në arabisht, mbi 400 kumtesa, artikuj, referate në shqip e arabisht, krahas veprave në dorëshkrim. I dyti, Imam Vehbi Ismaili, me 46 vepra të botuara, midis tyre 12 origjinale, qindra e qindra faqe shtypi, përkthime, artikuj, kumtesa, procesione e reportazhe.²⁰

Në vazhdimësinë e marrëdhënieve të ndërsjella me botën orientale, rolin kryesor e luajtën hoxhallarët elitarë, të arsimuar e kualifikuar në qendrat e mëdha të qytetërimit islam duke mos mbetur vetëm thirrës të fesë, por duke shërbyer edhe si mësues të gjuhëve të huaja, si përhapës të kulturës.

Çereku i parë i shekullit XX që dëshmitar i krijimit të një brezi të rinjsh të shkolluar në institucionet publike, siç qenë gjimnazi ushtarak, ai civil, shkolla normale, të ngritura nga administrata turke. Një pjesë e këtyre të rinjve patën mundësinë të vazhdonin shkollat e larta jashtë vendi, kurse pjesa tjetër u privua për arsye të luftërave ballkanike e më tej. Fatmirësisht, kontingjenti i dytë përbëhej nga të rinj studiozë e të talentuar për mësimin e gjuhëve të huaja si lindore, si perëndimore. Bazave të shëndosha, të marra në shkollë, ata i shtuan një punë të madhe individuale në fushën e orientalistikës. Në këtë kontingjent intelektualësh shekullarë vërejmë një diferencim në tipologjinë e përkushtimit. Njëri grup, i përbërë nga Sheuqet Mika, Junuz Bulaj e Hasan Haveriku, do t’i kushtojë fushës së islamologjisë, ndërsa tjetri, i përbërë nga Hamdi Bushati, Tahir Dizdari, Junuz Tafilaj, do të merrej me burimet arkivore, historiografinë, leksikografinë, përkthimet. Njohës të mirë të gjuhëve orientale ishin dhe të rinj të tjerë, jofetarë, të shkolluar në universitetet e Stambollit e të Kajros, si:

Hamid Gjylbegu, Qazim Dani, Ethem Osmani, vëllezërit Shkodra, Riza Dani, Hysni Peja etj., ndër të cilët veçojmë Hamid Gjylbegun që iu kushtua krijimtarisë letrare, si dhe Ethem Osmanin që iu kushtua arsimit.

Sheuqet Muka, krahas ndihmës së shquar në drejtim të forcimit të arsimit kombëtar, bëri përpjekje të dukshme duke përkthyer artikuj të fushës përkatëse, për të kaluar pastaj në përkthimin e "Jasinës" dhe, më vonë, në hartim me përshtatje teksti mësimor fetar "Ilmi Halle". Në arkivin e familjes ruhet një fond i pasur dorëshkrimesh në osmanishte.

Në radhën e dijetarëve shkodranë, pas një përvoje të vyer si mësues në disa shkolla të Anadollit, zë vend dhe Junuz Bulaj, ish-nëndrejtor i Medresesë së Tiranës. Mësuesi tjetër shkodran i asaj medreseje, Hasan Haveriku, qe, njëheri, koleg me Buljan, por edhe bashkëpunëtor në botimin e revistës "Zani i Naltë". Krahas kontributit në publicistikën fetare me përkthim e përshtatje në shqip, ai qe "violinë e parë" në grupin e përkthyesve dinjitozë të Kurabit, së bashku me H. Ismet Dibrën, H. Ibrahim Kadukun, Haki Sharofin, Junuz Bulajn.²¹ Nëse veprën e tij origjinale mbi Tarikatin Tixhani e trajtojmë si vepër islamologjike, botimin e Abetares arabisht, të cilësuar si më e mira e llojit, e vlerësojmë një sukses të orientalistikës sonë. Mendojmë se duhet marrë në konsideratën e specialistëve të fushës një aspekt i veçantë i afeksionit të tij për botën e orientit:²² paraqitja estetike e civateve kuranore dhe atyre të Profetit përmes ngjyrash e ornamentesh nga më të ndryshmet, plot motive floreale, realizuar me plot finesë, relike të vërteta të arteve figurative islamike, njëheri dëshmi e ndikimeve orientalistike në mjediset tona.²³

Studiuesi Hamdi Bushati, një veteran i arsimit kombëtar, falë punës sistematike individuale arriti në nivelet e duhura për zotërimin e gjuhëve të huaja të Lindjes e të Perëndimit, veçanërisht të osmanishtes. Kështu që nuk hezitoi t'i hynte një fushe pak të rrahur për kohën: përgatitja e teksteve shkollore për edukimin islam. Dy tekste të tilla, si dhe një përkthim nga turqishtja, miratuar nga organet përkatëse, qenë mirëpritur nga publiku.²⁴ Vitet që pasuan, qenë vite kushtuar hulumtimit dhe grumbullimit të lëndës burimore e dokumentare për Shkodrën e periudhës së Bushtallinjve, tematikë e përkushtimit të

mëvonshëm, që fatmirësisht i dha mundësinë të kalonte nëpër duar një pasuri burimore e dokumentare, e destinuar të humbiste si simotrat e saj. Duke regjistruar, kopjuar me transkriptim e transliterim, duke përkthyer e duke vënë në shërbim të lexuesve e të studiuesve me qindra e qindra faqe dokumentesh (tapi, dekrete, timare, qarkore, testamente, kontrata, lloj-lloj dëftesash, vendime të Xhibalit etj.), ditare, kronologji, gjenealogji etj., shumica në një osmanishte të vjetër, iu bë një shërbim i paçmuar historisë lokale e më tej. Ky kontribut do të pasurohej dhe me gjurmimet në terren për të realizuar “leximin”, thënë më saktë, deshifrimin dhe përkthimin e mbishkrimeve mbi varret e vjetra dhe mbi pllakat e vëna në hyrjet e xhamive, teqeve, tyrbeve, banjave etj., dhe këto në osmanishte e arabisht. Një fushë tjetër e suksesshme në lëmin e osmanologjisë është ajo e përkthimeve nga sfera e islamologjisë,²⁵ si dhe nga ajo e historisë së kulturës. Pavarësisht kthimit tek tematika fetare pas disa dekadash, është tematika jofetare ajo që do të zërë vendin kryesor si volum pune e si gjerësi temash: histori, krestomaci, enciklopedi, divulgim shkencor, jurisprudencë, psikologji. Kjo letërsi e gjerë, e kthyer në shqip, merr një kuptim e vlerë të veçantë, sepse krahas rolit informues me interes shkencor kulturor, ajo ka dhe një nëntekst të fortë formues edukativ, përderisa përmes evidentimit të krijimtarisë së rilindësve, kuptohet që ata s’e ndanë diturinë nga atdhedashuria.

Mbështetur në këtë kontribut, prof.dr. Gazmend Shpuza, në dy artikuj të mëparshëm, si dhe në veprën e tij të fundit, e rendit Hamdi Bushatin në plejadën e studiuesve të shkuar në fushën e orientalistikës sonë.²⁶

Me punën dhe përkushtimin e shkencëtarit të vërtetë, me Panteonin e vlerave të kulturës së mirëfilltë ka zënë vendin e merituar dhe orientalisti i rrallë dhe i përmasave të veçanta, Tahir Dizdari, dijetari shkodoran, fama e të cilit i ka kaluar kufijtë e atdheut tonë. Botimi i veprës së tij monumentale “Orientalizmat në gjuhën shqipe”, mbetur padrejtësisht sirtarëve për dekada të tëra, qe një sihariq i madh për tërë dashamirësit e shkencës e, në veçanti, një dhuratë e madhe për gjuhësinë tonë. Fillimet e kësaj nisme ambicioze të Dizdarit u përvijuan që në vitet ’44 të shekullit të kaluar, përmes rubrikës “Fjalë irانية në shqip”. Që

në dorëshkrim, përfunduar pas tri dekadash pune të lodhshme, vepra që vlerësuar më notat optimale nga studiuesit e huaj dhe autori pat marrë ftesën për në Kongresin Ndërkombëtar të Orientalistëve, Paris, 1973, ftesë që nuk u konsumua, sepse autori ndërroi jetë papritmas.²⁷ Akademiku hungarez, J. Nemeth, ka dhënë këtë vlerësim të lartë: “Nga vepra Juaj (e T. Dizdarit-shënimi ynë) do të përfitojnë të gjithë turkologët e botës. Në asnjërën prej gjuhëve të Ballkanit s’janë mbledhur elementet turke në mënyrë kaq të përsosur”.²⁸ Gjuhëtari turk A. Baha Ozler që shprehur kështu: “Kjo vepër e Dizdarit, fryt i një pune me të vërtetë të gjatë e të lodhshme, meriton me të vërtetë mburrje”.²⁹ Vlerësime të shumta i janë bërë veprës së mësipërme nga akademikë shqiptarë në dy veprimtari shkencore, njëra në Prishtinë, tjetra në Tiranë, si dhe përmes revistave shkencore e kulturore. Ndërsa prof.dr. Jup Kastrati, me një analizë të thelluar, e quante Dizdarin: “...dijetari më i shquar në fushën e gjurmimeve orientalistike”, duke e vlerësuar Fjalorin: “... një histori e kulturës dhe e qytetërimit shqiptar për një etapë të caktuar [...] një enciklopedi në miniaturë e botës shqiptare”.³⁰ Redaksia e revistës “Hylli i Dritës” dilte me këtë konkluzion: “Kur t’i kesh botuar Palat “Botën e maleve”, Dizdarit “Orientalimat në shqipen” apo Fishtës “Korpusin e veprave”, atëherë ke kryer një akt në dobi të kulturës.”³¹

Nuk mund të mbyllet vështrimi pa u ndalur edhe tek intelektual i Junuz Tafilaj, që debutoi në faqet e shtypit të kohës me përkthime letrare nga gjuhët evropiane e me artikuj publicistikë. Bëri emër me përkthimin e romanit bullgar “Mësuesi idealist”. Pas viteve ’50 u punësua si përkthyes nga osmanishtja pranë arkivave të institucioneve shkencore të Tiranës, duke bërë një punë shumë të dobishme dhe cilësore në ndihmë të hulumtimit shkencor historik.³²

Vitet ’80-’90 shënojnë mbylljen e periudhës së “artë” të veprimtarisë së orientalistëve shkodranë, në përputhje me shuarjen e tyre fizike, por kjo nuk do të thotë se, në qytetin e traditave të shëndosha kulturore, do të përjetohej një atmosferë asfiksuese e nismave dhe përkushtimit për arritje të reja në dobi të përpjekjeve të mësipërme. Krahas punës së kualifikuar në dy institucionet bashkëkohore e kompetitive, si Medreseja dhe

Kolegji turk, për mësimin e arabishtes dhe turqishtes, krahas pranisë së një kontingjenti të rinjsh, shkolluar në universitetet e Lindjes, është dhe shembulli pozitiv aktual i intelektualëve shkodranë: Ismail Muçej,³³ Gazmend Shpuza, Shefik Osmani, të cilët, në rrafshin studimor dhe botues, po pasurojnë kulturën shqiptare.

Duke u përqendruar, së pari, te dyshja Muçej-Shpuza, do të vërejmë se krahas së përbashkëtës, përkushtimit në fushën e orientalistikës, ata kanë dhe veçoritë e tyre, jo vetëm në drejtim të shkollimit, njëri-fetar, tjetri-laik, por edhe në drejtim të natyrës së veprimtarisë kryesore, i pari në publicistikë, i dyti në gjurmimin shkencor në histori.

Njohës i disa gjuhëve të huaja, lindore e perëndimore, Ismail Muçej është afirmuar tashmë si një ndër arabologët më të mirë të sotëm shqiptarë, jo vetëm përmes përkthimeve nga arabishtja, jo vetëm të lëndës fetare, botuar në "Drita Islame", për shumë vite e drejtuar prej tij, por kryesisht me veprën e tij madhore "Fjalori arabisht-shqip" dhe "Fjalori shqip-arabisht", (i pari me 45 mijë fjalë dhe 20 mijë shprehje, ndërsa i dyti me 25 mijë fjalë dhe 30 mijë shprehje). Është shumë dëshpërues fakti që kjo vlerë e paçmuar e leksikografisë sonë ka mbetur ende në dorëshkrim.

Pedagogu dhe historiani Gazmend Shpuza, autor i shumë punimeve shkencore, anëtar i disa forumeve shkencore brenda e jashtë vendit, është bërë i njohur në fushën e osmanologji si ekspert i paleografisë, diplomatikës, arkivistikës osmane, në ndihmë të ndriçimit të historisë sonë, dhe për ndihmesën e tij në fushim e iranologjisë, orientalistikës e albanologjisë si ish-kryeredaktor i revistës "Perla". Kontributi i tij i fundit në këtë fushë është botimi i veprës studimore-shkencore "Bota iraniane në veprën e Sami Frashërit", vepër e shkruar me profesionalizëm, ku analiza në thellësi ndihmohet dhe nga shikimi retrospektiv e ai perspektiv, ku pasurisë së informacionit interesant me "të panjohurat" i rri përkrah akribia shkencore, ku konformizmit të recetave të mykura plot histeri ksenofobe e falsifikime vulgare u kundërvihet argumentimi objektiv i pavarur.

Konkluzione

Njohja e gjuhëve të Lindjes e më tej që në dobi të zhvillimeve të karakterit arsimor-kulturor në mjedisin shkodran, duke krijuar mundësi shkëmbimesh e lidhjesh midis vendesh e popujsh në fusha të ndryshme të jetës lëndore mendore, por duke lënë dhe hapësirën e duhur, pa pengesa e kufizime, për njohjen dhe përvetësimin e gjuhëve evropiane dhe të perëndimit. Në një shtrat të tillë bashkëjetese të shumë gjuhëve e të shumë kulturave u formua elita intelektuale shkodrane, pjesë e rëndësishme e inteligjencies së kombit.

Bazat e dijetarëve të formuar qenë promotore të lëvizjeve atdhetare e shoqërore-përparimtare në vend. Në moment kyçe të historisë sonë ata u vendosën në vijën e parë të përpjekjeve me fjalë e me pendë e, pse jo, dhe me pushkë.

Lëvrimi dhe përvetësimi i gjuhës dhe i kulturës së Lindjes krijoi dhe premisat edhe të lëvrimit të shqipes përmes alfabetit turko-arab e, më vonë, përmes atij latin. Në sajë të këtij formimi shpirtëror e kulturor, këta dijetarë qenë bartës dhe frymëzues të frymës së vëllazërimit, të harmonisë e të tolerancës ndërfaqetare.

Shënime:

¹ Krahaso, "Iranologjia në botë", Në: Perla (1997), 2-3, fq. 67.

² Historia e popullit shqiptar. Akademia e Shkencave, Vëll.1. Tiranë, 2002, fq. 618.

³ Po aty, fq. 703

⁴ Hamdi Bushati: Shkodra dhe Motet, Vëll. 2, Shkodër 1999, Fq. 87-92.

⁵ Shefik Osmani: Kompleksi arsimor-kulturor i Pashllëkut të Bushatllinjve, Seminari i parë ndërkombëtar "Shkodra në shekuj", Shkodër 1994, fq.335.

⁶ Jup Kastrati: Biblioteka Këllici, Buletini BUSH, shkenca shoqërore, 2, Tiranë 1955, fq. 218-219.

⁷ Hamdi Bushati: Vep. e Cit. fq. 97-99.

⁸ Shefik Osmani. Vep. e Cit. fq. 336.

⁹ Gazmend Shpuza: Dorëshkrime orientale... Perlla (1998) 3, fq. 57-65. Shih po shut Nehat Krasniqi: Kontributi i Bushatllinjve të Shkodrës në fushën e kulturës. Në: Shkodra në shekuj. Vëll. 4/1. Shkodër 2002, fq. 111-114.

¹⁰ Gazmend Shpuza: Ibrahim Pasha, poet. Në: Kumtari (2002) 8, fq. 43-44. Shih